



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.279/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Adnan Kunushevcu dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur lidhur me ankesat e Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 06 tetor 2019, në seancën e mbajtur me 06.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohen të pabazuara** ankesat e subjekteve politike Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Anr.279/2019, dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Anr.280/2019 të datës 05.10.2019, me të cilat kanë kërkuar që subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), t'i shqiptohet dënim me gjobë për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore-dërgimit të mesazhit telefonik/bërjes fushat në çfarëdo mënyre.

## A r s y e t i m

Paraqitësit e ankesës, PDK dhe LDK, me seli në Prishtinë, me datën 05.10.2019, kanë paraqit ankesat në PZAP, me të cilat pretendohet se me datë 05.10.2019, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në Telefon, përmes SMS-ve, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerja e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të miratohet e bazuar.

Paneli, në bazë të nenit 8 paragrafi 3, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, poashtu për shkak se ankesat janë paraqitur ndaj të njëjtit subjekt dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provaveve materiale-fotografivive të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesat janë të pabazuara**

Nga shkresat e lëndëve vërtetohet fakti se në numrin telefonit që është dërguar sms përmes të cilit është bërë fushat zgjedhore.

Provat e vetme të dorëzuara nga ankuesit që janë nga një fotografi e sms/mesazhit në telefon, nuk kanë datë të dërgimit (kur është dërguar mesazhi), pra nuk mund të identifikohet pretendimi i parashtruesëve të ankesës se nga ana e subjektit politik LVV, është thyer heshtja zgjedhore përmes veprimit/ sponzorizimit të fushatës zgjedhore me anë të dërgimit të mesazhit telefonik, në mungesë të argumentimit të datës së dërgimit.

Paneli vlerëson se ankuesit në bazë të fotografive të prezentuara si prova materiale, të cilat gjinden në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet qartë dhe bindshëm siq përcaktohet me nenin 117 parag.3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, përmes thyerjes së heshtjes zgjedhore me datë: 05.10.2019, përmes të bërit fushatë në çfarëdo mënyre.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e konform nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.279 /2019 më datën 06.10.2019

**Kryesuesi i Panelit**

**Faton Adem**



***Këshillë Juridike:***

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së,